

VENDIM
Nr. 444, datë 27.5.2015

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 693, DATË 22.10.2014, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR KRIJIMIN E QENDRËS SË OFRIMIT TË SHËRBIMEVE PUBLIKE TË INTEGRUARA”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 10, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, dhe të nenit 6, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, me propozimin e ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 693, datë 22.10.2013, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Shkronja “a”, e pikës 2, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“a) ofrimin e shërbimeve publike nëpërmjet ngritjes dhe administrimit të sporteleve pritëse për qytetarët (*front office*) si dhe qendrave të shërbimeve publike të integruara me një ndalesë (*one-stop-shop*); për shërbimet që kryhen nga institucionet dhe agjencitë e qeverisë qendrore dhe/ose të njësive të qeverisjes vendore sipas legjislacionit në fuqi ose marrëveshjeve përkatëse.”.

2. Pas shkronjës “ç”, të pikës 3, shtohen shkronjat “d”, “dh”, “e”, “ë”, “f” e “g”, me këto përmbajtje:

“d) Mbikëqyr zbatimin e procedurave dhe standardeve në sportelet pritëse për qytetarët (*front office*) duke garantuar cilësi, efektshmëri dhe transparencë;

dh) Është përgjegjëse për ngritjen dhe menaxhimin e qendrave të ofrimit të shërbimeve publike të integruara;

e) Garanton aksesin për të gjithë qytetarët dhe saktësinë e informacionit për procedurat administrative, nëpërmjet kanaleve të ndryshme moderne të komunikimit;

ë) Ndërton, përditëson dhe mirëmban inventarin qendror të procedurave administrative në nivel qendror të Republikës së Shqipërisë, sipas standardeve të BE-së, në kuadër të kategorizimit dhe kodifikimit;

f) Kryen rregullisht optimizimin e proceseve administrative në të gjitha institucionet publike sipas metodologjisë së riinxhinierimit;

g) Harton dhe përditëson formularët standardë për marrjen e shërbimeve publike si dhe mirëmban bankën tyre, për t'u aksesuar nga çdo punonjës i administratës publike.”.

3. Ngarkohen ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike dhe Qendra e Ofritit të Shërbimeve Publike të Integruara për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama